

**Projekti për Emërimet në Pozita të Larta në Kosovë**  
**Partneri Zbatues**  
**Deklaratë për Menaxhimin e të Dhënave**

BDO është Partneri Zbatues i projektit të Ambasadës Britanike për përkrahje të Rekrutimeve të Pavarura, Llogaridhënëse, Meritokratike dhe Profesionale në Kosovë. Projekti mbështetet në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga Kryeministri Avdullah Hoti dhe Ambasadori Britanik Nikolas Abot më 2 korrik 2020. Sipas kushteve të Memorandumit, Partneri Zbatues do të përfshihet në një listë të dakorduar të pozitave të larta në Kosovë.

Si pjesë e këtij projekti, anëtarët e ekipit të projektit të Partnerit Zbatues do të duhet të kenë qasje në të dhënat personale të aplikantëve dhe kandidatëve. Kjo deklaratë thekson parimet dhe praktikën të cilat Partneri Zbatues do t'i adoptojë gjatë menaxhimit të të dhënave tuaja personale sipas legjislacionit të Kosovës.

### **Deklaratë**

Ne e kuptojmë që të dhënat tuaja personale janë të rëndësishme për ju. Për të pasur kontroll se kur dhe si të dhënat tuaja grumbullohen, përpunohen, ruhen, asgjësohen dhe se kush do të ketë qasje në to është rregulluar me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03 L-172). Ne i respektojmë të drejtat tuaja ligjore dhe kemi vendosur praktika për të siguruar që menaxhimi i të dhënave tuaja personale të jetë në përputhje me pritjet ligjore, morale dhe etike.

### **Pëlqimi me shkrim i bazuar në informim**

Para se të grumbullohen, përpunohen ose ruhen të dhënat tuaja – nga ju do të kërkohet që të jepni pëlqimin me shkrim. Pëlqimi do të jetë i bazuar në informim pasi që do të theksojë qartazi:

- Qëllimin specifik për të cilin grumbullohen të dhënat tuaja dhe se si do të përdoren ato.
- Si do të ruhen të dhënat tuaja dhe kush do të ketë qasje në to.

### **Qëllimi i grumbullimit, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave**

Të dhënat tuaja do të grumbullohen, përpunohen dhe ruhen vetëm lidhur me aplikimin dhe vlerësimin për një pozitë të lartë ku është i përfshirë Partneri Zbatues për të ofruar përkrahje dhe mbikëqyrje të atij procesi. Partneri Zbatues nuk do të kërkojë nga ju që të jepni pëlqimin për ndonjë proces ku ata nuk janë të përfshirë.

Të dhënat tuaja nuk do të përdoren për qëllime tjera që nuk ndërlidhen me përkrahjen, mbikëqyrjen apo raportimin e procesit të përzgjedhjes.

### **Ruajtja e të dhënave**

Të dhënat e grumbulluara nga Partneri Zbatues lidhur me rolin e tyre në proceset e emërimeve të larta, do të ruhen në mënyrë të sigurt nga Partneri Zbatues në sistemin e tyre.

Të dhënat në këtë sistem i nënshtrohen të drejtave të qasjes së përbashkët. Vetëm anëtarët e ekipit të projektit që kanë nevojë të qasën, përpunojnë dhe përdorin të dhënat tuaja, do të kenë qasje.

Të dhënat tuaja personale ruhen vetëm për atë kohë sa ka nevojë legjitime për të përdorur dhe përpunuar të dhënat tuaja lidhur me rolin e Partnerit Zbatues dhe përgjegjësitë në kuadër të projektit dhe sipas kushteve të Memorandumit.

Sa më parë që të mos ketë më nevojë legjitime për të përdorur ose përpunuar të dhënat tuaja personale, ato do të asgjësohen.

Në momentin kur të mos ketë më qëllim legjitim për të ruajtur të dhënat tuaja, ato do të asgjësohen.

## Mbrojtja e të dhënave – Formulari i dhënies së pëlqimit bazuar në informim

Unë ..... (emri me shkronja shtypi) i jap pëlqimin tim Partnerit Zbatues të Projektit të Ambasadës Britanike për Emërime në Pozita të Larta për të grumbulluar, ruajtur, përpunuar dhe sipas nevojës për të asgjësuar të dhënat e mia personale lidhur me aplikimin tim për pozitën ..... (vendos pozitën).

### Qëllimi dhe përdorimi

Ky pëlqim kufizohet në të dhënat që kanë një përdorim legjitim gjatë aplikimit dhe procesit të intervistës për të vlerësuar përshtatshmërinë e kandidatit për pozitën për të cilën aplikon. Të dhënat tuaja nuk do të përdoren për ndonjë qëllim tjetër që nuk lidhet me përmbushjen e rolit të Partnerit Zbatues. Të dhënat tuaja nuk do të përdoren për ndonjë proces tjetër përveç këtij që ceket më sipër.

### Qasja në të dhëna

Ky pëlqim u mundëson anëtarëve të caktuar të ekipit të projektit nga Partneri Zbatues që të grumbullojnë, ruajnë dhe përpunojnë të dhënat e mia personale. Ky pëlqim nuk përfshin individët apo të tjerët brenda apo përtej ekipit të projektit të Partnerit Zbatues.

### Ruajtja e të dhënave

Të dhënat tuaja do ruhen në mënyrë të sigurt dhe vetëm ata që kanë autorizim do të kenë qasje në to. Qasja është e kufizuar vetëm për anëtarët e ekipit të projektit të Partnerit Zbatues.

### Mbajtja dhe asgjësimi i të dhënave

Të dhënat tuaja ruhen vetëm aq sa ka nevojë absolute. Pasi të përfundojë kjo periudhë të dhënat tuaja do të asgjësohen dhe nuk do të mbahen më.

Intervista juaj do të transmetohet drejtpërdrejtë përmes një video sistemi konferencash për Partnerët Zbatues që punojnë nga distanca. Në rast se humb transmetimi i drejtpërdrejtë, do të ketë një mbështetje të regjistrimit-audio. Kjo do të përdoret vetëm për të mundësuar anëtarët e ekipit të Partnerit Zbatues që të kryejnë vlerësime nga distanca. Pasi të jenë përfunduar vlerësimet, regjistrimi do të shkatërrohet menjëherë.

### Kandidatët që mund të emërohen

Roli i Partnerit Zbatues kërkon që të raportojmë për çdo proces. Për të përmbushur kërkesën për transparencë më të madhe, Partneri Zbatues publikon emrat dhe poentimet e kandidatëve të cilët ata i identifikojnë si kandidatë që mund të emërohen, në faqen [www.kosovoselection.org](http://www.kosovoselection.org).

### Pëlqimi i bazuar në informim

Kam lexuar tekstin e mësipërm dhe jap pëlqimin tim të bazuar në informim, që të dhënat e mia të sistemohen, ruhen, përpunohen dhe asgjësohen sipas definicioneve dhe shpjegimeve të paraqitura më lartë.

Nënshkrimi:.....

Data:.....